



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë ,më 02.07.2025

PROCESVERBAL – KONTRATE MALLI
ME OBJEKT

(“BLERJE KAMIONCINE PËR BASHKINË KRUJË”)

**PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot me date 02.07.2025 ne Kruje ,nga ana e Njesise se Prokurimit te ngritur me urdherin **nr. 208 datë, 02.07.2025** me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar ”, me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje kamioncine për Bashkinë Krujë”

- KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
34136200-1 kamioncina
- **VLERA E FONDIT LIMIT: prej 1,583,000 (nje milion e peseqind e tetedhjetë e tre mije) lekë pa tvsh.**

BURIMI FINANCIMIT :TE ARDHURAT E BASHKISE KRUJE .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; (ne masen prej 2% te vleres se fondit limit te kontrates)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Referuar Ligjit 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” , Operatori ekonomik duhet te kete të regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik duhet te kete përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat; operatori ekonomik nuk duhet te kete asnje anëtar te një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij; te dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrimeve te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2025 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2025 per secilin operator)

Shenim-Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9 , ndersa operatori ekonomik fitues, para lidhjes se kontrates, duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2025 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve

duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2025 per secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Krujë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Per te provuar permbushjen kriterëve ekonomike e financiare operatori ekonomik duhet te plotesoje

kerkesat minimale si me poshte duke dorezuar :

a)Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2022.2023.2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te kontrates, qe prokurohet përkatësisht ne shumen prej **633,200 (gjashteqind e tridhjetë e tre mije e dyqind) leke pa t.v.sh**

Shenim-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur edhe vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43.2.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së

Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rendesishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e një kufiri të ulët dhe iu jep mundësi në të tjerë dhe operatorëve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

2.2.-b Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përvojë e sukseshme në lehtësimin e furnizimit të mallrave si më poshtë:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , me një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht jo më pak se vlera **316,600 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) leke pa t.v.sh,** dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b)-për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontraten pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Krujë), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a) Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër të furnizojë/transportojë mallrat objekt kontrate, në vendet e përcaktuara nga ana e Bashkisë Krujë me mjetet e tij që ka në dispozicion sipas kërkesës së AK. (Deklarate të leshuar nga Administratori i shoqërisë)

Kërkesat e mësipërme janë vendosur nga ana e AK në përputhje me nenin 44.2 e vijues të VKM nr 285 datë 19.05.2021 nëpërmjet të cilave kërkohet që Kur autoriteti/enti kontraktor prokuror furnizime me karakteristika specifike ose specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së

d).Operatori duhet te paraqese nje deklarate garancie per nje periudhe 1 vjecare per defektet te paparashikuara per mjetin ne te cilen te jete te percaktuar qarte te gjitha kushtet e garancise teknike te mjetit(kjo pike plotesohet me paraqitjen e vetedeklarimit te kandidatit ofertues).

Kerkesat e mesiperme jane vendosur nga ana e AK ne perputhje me nenin 44.2 e vijues te VKM nr 285 date 19.05.2021 nepermjet te cilave kerkohet qe Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron furnizime me karakteristika specifike ose specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Nr	Emërtimi i makinerisë	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimit
1	Kamionçinë vetëshkarkuese	cope	1	30 (tridhjetë) ditë

Hartimi i specifikimeve teknike për blerjen e artikujt te mesiperme është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorise se Sherbimeve dhe Investimeve Publike **nr.3851 Prot, date 29.05.2025** ,duke identifikuar specifikimet standarte dhe karakteristikat perkatese teknike.te cilat plotesojne nevojat respektive te Bashkise Kruje .

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallit që prokurohet, duke e përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.

- **Fondi limit** per proceduren me objekt , **“Blerje kamioncine per Bashkinë Krujë”**, eshte hartuar duke iu referuar cmimeve te tregut per kategorin e mallrave/artikujve te ngjashem ,sipas referimeve dhe metodave te parashikuara ne nenin 76.c te Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 , “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

PER NJESINE E PROKURIMIT PUBLIK